

12

13

14

15

Emri FatMbiemri A

Konvikti _____

Fakulteti FUdhëheqësi (N)
i konviktitEmri U

Mbiemri _____

Konvikti _____

Fakulteti _____

Udhëheqësi
i konviktitEmri MMbiemri A

Konvikti _____

Fakulteti _____

Emri DorMbiemri BytKonvikti NrFakulteti PA

**RAPORT NGA MONITORIMI
I KONKURSIT PËR SHFRYTËZIMIN
E KONVIKTIT DHE MENSËS NË
QENDRËN E STUDENTËVE TË UP
PËR VITIN AKADEMIK 2015-2016**

KALLXO
.com



**RAPORT NGA MONITORIMI I
KONKURSIT PËR SHFRYTËZIMIN
E KONVIKTIT DHE MENSËS NË
QENDRËN E STUDENTËVE TË UP
PËR VITIN AKADEMIK 2015-2016**

REDAKTOR:

Faik Ispahiu

AUTORË:

Petrit Kryeziu, Lekë Muqaj dhe Faik Ispahiu

MONITORUESIT:

Petrit Kryeziu, Lekë Muqaj dhe Armend Zenelaj

UDHËHEQËS I DESKUT PLANIFIKUES:

Muhamet Hajrullahu

REDAKTORË DESKU:

Përparim Isufi, Ervin Qafmolla, Bekim Muhaxheri, Parim Olluri

MENAXHERE E PROJEKTEVE:

Albulena Sadiku

REDAKTOR I RRJETEVE SOCIALE:

Valon Canhasi

PËRKRAHJA TEKNIKE:

Arian Hyseni, Yllka Hoxha, Ermal Gashi.

PËRMBAJTJA

PËR KALLXO.COM	06
----------------	----

HYRJE	07
-------	----

PËRMBLEDHJE	08
-------------	----

METODO LOGJIA	09
---------------	----

VLERËSIMI I APLIKACIONEVE	10
---------------------------	----

GJETJET E MONITO RIMIT	13
------------------------	----

VLERËSIMI I PROCESIT	14
----------------------	----

REKOMANDIME	15
-------------	----

PËR KALLXO.COM

Platforma online www.KALLXO.com është projekt i përbashkët i organizatave Internews Kosova (I/KS), Rrjetit Ballkanik i Gazetarisë Hulumtuese (BIRN), OJQ-së “LENS” dhe Agjencisë Kundër Korrupsion (AKK), ndërsa përkrahet nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) me mbështetje të SDC.

Platforma KALLXO.com ofron mundësinë për të gjithë qytetarët që të raportojnë rastet e korrupsionit, krimit të organizuar, mashtrimit, konfliktit të interesit si dhe të gjitha rastet e tjera të keqpërdorimit të pozitës zyrtare, neglizhencës, mos punës, rrezikimit të të drejtave të qytetarëve të Kosovës, apo rrezikimit të interesave të përgjithshme.

Internews Kosova (I/KS) është organizatë joqeveritare, e themeluar në vitin 1999 nga një ekip i guximshëm vendor dhe ndërkombëtar. I/KS është organizatë e pavarur e cila që nga themelimi i vet është angazhuar në zhvillimin e mediave të pavarura, gazetarisë hulumtuese dhe demokratizimit të shoqërisë në Kosovë e rajon.

Rrjeti Ballkanik i Gazetarisë Hulumtuese (BIRN) është organizatë mediale e specializuar për gazetari hulumtuese, monitorim të shërbimeve publike dhe transmetime televizive.

I/KS në bashkëpunim me BIRN-in prodhon emisionet “Jeta në Kosovë” dhe “Drejtësia në Kosovë”, publikon online Gazetën “Jeta në Kosovë” dhe boton gazetën e vetme në gjuhën angleze në Kosovë “Prishtina Insight”. Gjithashtu, Internews Kosova dhe BIRN-i monitorojnë shërbimet publike si dhe zgjedhjet lokale e parlamentare në Kosovë.

HYRJE

Në prag të vitit të ri akademik, Qendra e Studentëve e Universitetit të Prishtinës (QS e UP) ka shpallur konkursin publik për akomodim në konvikte dhe shfrytëzim të shërbimeve të mensës në QS të UP.

Konkursi është shpallur publikisht me 03 shtator 2015 dhe ka qenë i hapur deri më 11 shtator 2015, gjithsej 8 ditë për të gjithë studentët e Universitetit të Prishtinës.

Me 01.09.2015, Fatmir Sfishta, Drejtor i Qendrës së Studentëve të Universitetit të Prishtinës dhe Faik Ispahiu, Drejtor Ekze-

kutiv i Internews Kosova kanë nënshkruar Marrëveshje të Mirëkuptimit¹ për të monitoruar procesin e vlerësimit të konkursit për akomodim në konvikte dhe shfrytëzimin e shërbimeve të mensës në QS të UP.

Në bazë të Marrëveshjes së Mirëkuptimit, KALLXO.com ka monitoruar këtë proces.

1 <http://live.kallxo.com/sq/MTL/Kallxocom-Monitoron-Konkursin-e-Konvikteve-8059>



PËRMBLEDHJE

Sipas të dhënave zyrtare, QS e UP ka kapacitet të akomodimit për 3,531 studentë në konvikte si dhe për ushqim të 1,500 studentëve shtesë në mensën e QS të UP.

Në konkursin publik të shpallur me 03 shtator kanë aplikuar 6,700 studentë dhe pas vlerësimit janë pranuar 3,475 prej tyre (2,097 femra dhe 1,378 meshkuj).

Afati i ankesave ka qenë prej 28 deri më 29 shtator. QS e UP ka pranuar 1,376² ankesa, prej të cilave 41 (26 femra dhe 15 meshkuj) janë vlerësuar pozitivisht dhe pranuar për akomodim.

Komisioni vlerësues i ankesave është përbërë nga: Behram Behluli- kryetar i komisionit për ankesa, Avdurrahman Behrami- nga QS dhe Egzon Daku- nga Parlamenti Studentor.

Për shkak të mosplotësimit të vendeve të lira të lëna për ankesa, të cilave i janë shtuar edhe 88 vende tjera të lira, të cilat sipas drejtorit të strehimit Isak Beha kanë ardhur si rezultat i heqjes dorë nga studentët përfitues të konviktorëve. Këta të fundit kanë kërkuar që të gëzojnë vetëm të drejtën në Mensë.

Bordi i Qendrës Studentore, në krye me drejtorin e QS Fatmir Sfishta, ka vendosur që të gjitha këto vende të plotësohen.

Nga gjithsej 144 vendet e lira (këtu përfshihen edhe 56 vendet e rezervuara për ankesa) janë plotësuar në këtë mënyrë:

- 41 vende kanë fituar të drejtën si rezultat i ankesave të bazuara, prej tyre 26 femra dhe 15 meshkuj. Pasiqë me plotësimin e 41 vendeve me ankesa të bazuara nuk është plotësuar numri i vendeve të lira në konvikte, Bordi i QS ka vendosur që këto vende të plotësohen duke pranuar fëmijët e dëshmorëve, studentët me notë mesatare mbi 9.0, studentët me gjendje të rëndë sociale dhe fëmijët e martirëve

të luftës, të gjithë këta studentë nga lista e ankesave.

- 7 vende janë plotësuar nga listat e fëmijëve të dëshmorëve, prej tyre 4 meshkuj dhe 3 femra.
- 47 vende janë plotësuar me notë mesatare mbi 9.0. Prej tyre 23 femra dhe 24 meshkuj.
- 15 vende janë plotësuar nga lista e studentëve me gjendje të rëndë sociale (të gjithë meshkuj, ngase vendet e rezervuara për femra ishin plotësuar).
- 4 vende janë plotësuar nga lista e fëmijëve të martirëve të luftës (të gjithë meshkuj).
- Një vend është plotësuar me vendim të drejtorit të strehimit Isak Beha, në afatin e dytë, për një studente nga Presheva nga fakulteti i mjeksisë e cila jeton pa të dy prindërit.
- si dhe janë pranuar edhe 29 studentëtjerë nga organizatat studentore, listën e të cilëve e ka sjellur Parlamenti Studentor në bazë të Memorandumit të lidhur mes Parlamentit Studentor dhe Ministrisë së Arsimit.

Në platformën KALLXO.com janë paraqitur 4 ankesa, të cilat i janë drejtuar më tutje komisionit vlerësues të ankesave për konkurs. Ky komision, pas vlerësimit të ankesave ka ardhur në përfundimin që dy prej ankesave të studentëve kanë qenë të bazuara dhe kanë përfituar të drejtën për akomodim konviktor dhe mensë, ndërsa dy ankesat tjera nuk i kanë arritur kriteret e kërkuara me konkurs.

Numri përfundimtar i studentëve të cilët janë akomoduar në konviktet e QS të UP është 3,531 ndërsa numri përfundimtar i studentëve të cilët kanë fituar të drejtën për t'u ushqyer në mensën e QS të UP është 5,000 (duke përfshirë edhe 3,531 studentët që gëzojnë të drejtën pos në banim edhe në mensë).

² <http://live.kallxo.com/sq/MTL/Rreth-1-400-Ankesa-per-Vende-ne-Konvikte-8438>

METODOLOGJIA

Vlerësimi i dokumentacioneve të studentëve aplikues është bërë nga 15 deri më 22 shtator 2015 nga tri komisione, të përbëra nga dy zyrtarë të Qendrës së Studentëve për secilin komision.

Grupi i parë i komisionit është përbërë nga: Fahri Osmani dhe Shefqet Krasniqi- nga QS e UP. Ky komision ka bërë vlerësimin e dokumentacioneve të fakulteteve: Ekonomik, Juridik, Bujqësi dhe Edukatë Fizike.

Grupi i dytë i komisionit është përbërë nga: Bislum Berisha- nga QS dhe Arben Mehmeti – nga Parlamenti i Studentëve. Ky komision ka bërë vlerësimin e dokumentacioneve të fakulteteve: Mjekësi, FShMN, Fakulteti i Arteve dhe Fakulteti i Edukimit.

Grupi i tretë i komisionit është përbërë nga: Xhevahire Klaiqi dhe Avdi Fetahu- nga QS. Ky komision ka bërë vlerësimin e dokumentacioneve të fakulteteve: Teknik, Filologjik dhe Filozofik.

Ekipi monitorues i KALLXO.com, i përbërë nga Petrit Kryeziu, Armend Zenelaj dhe Lekë Muqaj e kanë monitoruar procesin e vlerësimit në tërësi nga afër duke pasur qasje në çdo dosje dhe secilin dokument.

Ekipi monitorues ka mbajtur listë paralele të vlerësimit të secilit kandidat dhe i ka krahasuar me listat finale të Komisionit Vlerësues të Konkursit.



VLERËSIMI I APLIKACIONEVE

Vlerësimi i dokumentacioneve të studentëve është bërë në njërën nga sallat e Konvikteve të QS të UP, në kushte të mira për punë dhe pa ndërhyrje të personave të paautorizuar.

Vlerësimi është bërë në bazë të këtyre kritereve:

-Nota mesatare: varësisht nga lartësia e notës mesatare kanë qenë të përcaktuara edhe pikët.

Minimumi ka qenë nga 5 deri në 15 pikë. Kriteret për notë mesatare kanë qenë si më poshtë:

Ndërsa studentët e vitit të parë kanë marrë në start 15 pikë.

Gjatë vlerësimit, komisioni vlerësues ka marrë vendim që aplikantët të cilët kanë notën mesatare më të lartë se 9.5 dhe udhëtojnë më shumë se 25 kilometra të sistemohen me automatizëm në qendrën e studentëve³.

6.0 - 6.6	MERR	5 PIKË	6.7 - 7.2	MERR	6 PIKË
7.4 - 7.9	MERR	7 PIKË	8.0 - 7.2	MERR	12 PIKË
7.4 - 7.9	MERR	13 PIKË	9.2 - 9.7	MERR	14 PIKË
9.8 - 9.10	MERR	15 PIKË			

³ Shih Aktvendimi QS të UP të datës 15.09.2015, pika 1.

-Largësia e vendbanimit: varësisht nga largësia, poentimet janë bërë nga 2 deri në 10 pikë.

Poentimi- pikëzimi sipas largësisë së komunave është bërë në këtë mënyrë:

PRIZREN	7 PIKË	BURIM	8 PIKË
GJAKOVË	8 PIKË	DEÇAN	9 PIKË
RAHOVEC	5 PIKË	DARDANË	7 PIKË
BESIANË	3 PIKË	MALISHEVË	4 PIKË
SKENDERAJ	5 PIKË	SHARR (DRAGASH)	10 PIKË
MITROVICË	3 PIKË	SHTËRPECË	6 PIKË
DRENAS	3 PIKË	SHTIME	2 PIKË
SUHAREKË	6 PIKË	ARTANË	3 PIKË
PEJË	8 PIKË	KLINË	6 PIKË
FERIZAJ	3 PIKË	ALBANIK	6 PIKË
KAÇANIK	6 PIKË	HANI I ELEZIT	7 PIKË
GJILAN	4 PIKË	JUNIK	10 PIKË
VUSHTRRI	2 PIKË	ZUBIN POTOK	6 PIKË
VITI	5 PIKË	LEPOSAVIQ	6 PIKË

Ndërsa të gjithë studentët që janë jashtë territorit të Republikës së Kosovës, me automatizëm kanë fituar nga 15 pikë.

- **Gjendja statusore:** në bazë të gjendjes statusore familjare, studentët aplikantë janë poentuar me pikë shtesë nëse studenti është:

FËMIJË I DËSHMORIT	10 PIKË
FËMIJË I PRINDIT INVALID TË LUFTËS	5 PIKË
I VETERANIT TË LUFTËS	5 PIKË
I TË PAGJETURIT	5 PIKË
STUDENT- INVALID CIVIL I LUFTËS	5 PIKË
STUDENT ME AFTËSI TË KUFIZUARA	5 PIKË
FËMIJË I TË BURGOSURIT- PËRNDJEKURIT POLITIK	5 PIKË
DËSHMIA- KARTA SOCIALE (për familjet që marrin ndihmë sociale)	3 PIKË
DËSHMIA (ekstrakt i lindjes dhe vërtetim nga fakulteti) më shumë se një student nga një familje	3 PIKË

Për të gjitha kriteret e lartëcekura, studentit ka qenë i detyruar që të bashkëngjese dëshminë përkatëse në aplikacionin e tij. Aplikacionet e pakompletuara nuk janë marrë në shqyrtim.

Në Aktvendimin e datës 15.09.2015 pika 2, komisioni vlerësues poashtu ka vendosur që fëmijët e punëtorëve të Qendrës së Studentëve (emrat e njohur për KALLXO.com) të cilët udhëtojnë më shumë se 25 km nga kryeqyteti të pranohen me automatizëm.¹ Monitorimi ka treguar se ky ven-

dim ka privilegjuar vetëm 8 raste apo më pak se 0.3% nga numri total i kandidatëve të pranuar. Megjithatë, monitorimi ka vërejtur se në sërë paku tri raste, janë pranuar familiarë si vëllau, e fejuara, nipi, etj. e jo fëmiju i punëtorit të QS të UP.

¹ Shih Aktvendimi QS të UP të datës 15.09.2015, pika 2.

GJETJET E MONITORIMIT

Gjatë procesit të vlerësimit janë vlerësuar gjithsej 6,700 aplikacione. Prej tyre, Komisioni Vlerësues ka pranuar 2,097 femra dhe 1,378 meshkuj.

Nga 2,097 femrat përfituese për banim në konvikt dhe mensë, komisioni ka vendosur që çdo aplikante femër që ka pasur mbi 19 pikë të pranohet në konvikt dhe mensë, në përjashtim të fakultetit të mjekësisë dhe teknikut (për shkak të specifikave të këtyre fakulteteve) të cilat kanë përfituar të drejtën me 18 pikë.

Nga 1,378 meshkujt përfitues për banim në konvikte dhe mensë, komisioni ka vendosur që çdo aplikant mashkull që ka arritur 20 pikë të pranohet në konvikt dhe mensë, në përjashtim të fakultetit teknik, art, edukim dhe filologjik (për shkak të numrit të madh të aplikantëve) të cilët kanë përfituar të drejtën me 19 pikë.

Nga ky proces kanë mbetur 56 vende të lira të cilat do të plotësoheshin pas shqyrtimit të ankesave. Prej tyre, 34 vende për femra dhe 22 vende për meshkuj.

Kapaciteti i përgjithshëm i vendeve në konvikte është 3,531 studentë.

Kapaciteti i përgjithshëm i mensës (pos 3,531 studentëve të pranuar në konvikte dhe mensë) është edhe për 1,469 vende të tjera për ushqim të studentëve që janë me banim jashtë konvikteve.

Nga 1,469 vendet e Mensës, kanë përfituar 1,446 studentë, me nga 15 pikë, përjashtimisht fakultetit teknik dhe mjekësisë të cilët këtë të drejtë e kanë fituar me nga 14 pikë.

Poashtu në fazën e ankesave, kanë përfituar të drejtën e ushqimit në mensë edhe 23 studentë.

Komisioni ka shqyrtuar edhe "Listën e Zezë" të studentëve, të cilët gjatë kohës së banimit në vitin e kaluar kanë shkelur rregulloren e Qendrës së Studentëve. Mirëpo nga kjo listë nuk është evidentuar asnjë student aplikues për këtë vit.



VLERËSIMI I PROCESIT

Monitoruesit e KALLXO.com, kanë pasur qasje pa pengesë në monitorimin e tërë procesit dhe dokumentacionit vlerësues, kjo në bazë të marrëveshjes së nënshkruar mes Internews Kosova dhe Qendrës së Studentëve të Universitetit të Prishtinës.

Monitoruesit kanë vlerësuar se anëtarët e komisioneve kanë qenë korrekt gjatë vlerësimit të dokumentacioneve, mirëpo në fund të procesit pas krahasimit mes listave të KALLXO.com dhe QS e UP dhe pas verifikimit të sërishëm të aplikacioneve, janë gjetur lëshime në 78 raste nga ana e OS e UP-së.

77 prej tyre janë studentë (emrat e njohur për KALLXO.com) të cilët nuk është dashur të pranohen, ngase nuk kanë arritur pikët sipas kriterëve të kërkuara, mirëpo në realitet emrat e tyre kanë dalë në listat e studentëve përfitues. Në njërin rast, studentja ka arritur pikët për pranim, mirëpo emri i saj nuk ka dalur në listat e studentëve përfitues të konviktoreve dhe mensës.

Lidhur me këto parregullësi QS e UP, ka pranuar se ka patur tek një numër prej mbi 70 studentësh gabime të natyrave të ndryshme si: gjatë poentimit të dokumentacionit, gjatë sortimit, gjatë renditjes së pikëve në tabela etj, duke rezultuar që emrat e këtyre studentëve janë përfshirë në listat përfundimtare të pranimit.

Ky numër i gabimeve shprehur në përqindje sipas Qendrës së Studentëve është 1.1% nga 6.700 studentëve aplikantë.

Drejtori i përgjithshëm i QS të UP-së, ka shprehur pakënaqësi me shkallën e gabimeve të lëshuara gjatë procesit dhe ka paralajmëruar se pas analizës dhe përfundimit të gjithë procesit do t'i marrë masat e nevojshme ligjore për komisionin qendror, ndërsa nuk ka dhënë përgjigje


se çka do të ndodhë me studentët që nuk
është dashtë të pranohen e të cilët janë
akomoduar në konvikte!

KALLXO.com, ka analizuar edhe hartën topografike të shprehur në përqindje të studentëve përfitues për konviktore dhe mensë.

Nga numri i përgjithshëm përfitues, Sken-deraj del të jetë komuna me më së shumti studentë të pranuar në konvikto-re dhe mensë, me 11.4% i përcjellur më pas nga Istogu me 10.8%, përderisa komunat me më së paku studentë përfitues janë nga Mitrovica Veriore dhe Klllokoti me vetëm 0.1%. Ndërsa studentët jashtë territorit të Kosovës kanë përfituar të drejtën për ban-im dhe ushqim në OS të UP- së në 10.5 %.

PËRQINDJA STUDENTËVE TË PRANUAR NË KONKURSION E OS-SË

(sipas listave të monitoruesve)



REKOMANDIME:

1

Të aplikohet sistemi i aplikimit online për të gjithë aplikuesit, në mënyrë që të automatizohet rangimi dhe përzgjedhja e aplikuesëve. Me një sistem të tillë online, i cili do të duhej të ishte i lidhur drejtpërdrejt me sistemin SEMS të UP për verifikim automatik, i tërë procesi i rangimit do të ishte transparent së bashku me listën e pritjes dhe puna e vetme e komisionit do të ishte konfirmimi i rregullsisë së dokumentacionit të kandidatëve të përzgjedhur.

2

Vendimet për pranim automatik të aplikantëve me notë mesatare mbi 9.5 dhe fëmijëve të puntorëve të QS së UP të cilët udhëtojnë më shumë se 25km nga kryeqyteti, do të duhej të ishin pjesë e kriterëve të publikuara në fillim tëshpalljes së konkursit për të siguruar transparencë të plotë.

3

Të futet si pjesë e kriterëve në poëtim edhe kategoria e fëmijëve të martirëve (civil) të luftës, ngase është e vetmja kategori e cila nuk ka përfituar pikë shtesë në vlerësim. Duke marrë parasysh faktin se kjo kategori e studentëve kanë humbur njërin prind në luftë dhe poashtu kjo kategori merr pension shumë më të ulët sesa kategoria e familjeve të dëshmorëve, për shkak të gjendjes sociale-familjare, do të duhej të parashiheshin pikë shtesë në listën e kategorive përfituese, njëjtë sikurse janë paraparë edhe për kategoritë e tjera të lartëcekura.





RAPORTO KORRUPSIONIN!
044 22 44 98

**RAPORT NGA MONITORIMI I KONKURSIT
PËR SHFRYTËZIMIN E KONVIKTIT DHE MENSËS NË QENDRËN
E STUDENTËVE TË UP PËR VITIN AKADEMIK 2015-2016**

Internews Kosova

"Mensa e Studenteve" Kati i parë,
Prishtinë 10 000, Kosovë
www.internewskosova.org
info@internewskosova.org

Dizajni nga:
project.GRAPHICS